



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
*Seksioni i Veçantë*



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201601876/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandojmë marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjyqimit të dosjes administrative me Nr.31005-02266-86-2015 akti datë 17.04.2015, të shtetasit Sh. P. nga Tirana.*

**Drejtuar :** **Z.Kastriot SELITA**  
**Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit**

**TIRANË**

***I nderuar zoti Kryetar,***

Në ankesën e tij datë 15.09.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Sh. P. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për zvarritje të padrejta gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore, në lidhje me gjykimin e një çështje administrative e regjistruar për gjykim pranë asaj Gjykate me datë 17.04.2015, dhe nga ana juaj deri më sot nuk është planifikuar akoma gjykimi i saj.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rezultoi se me vendimin Nr.884 datë 24.02.2015 Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë, është vendosur : Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Sh. P., Shfuqizimin e akteve administrative të DRSSH Tiranë dhe detyrimin e Palës së paditur DRSSH Tiranë, që në caktimin e pensionit të invaliditetit për paditësin të marrë në konsideratë vitet e punës në Uzinën Mekanike Kukës nga data 15.06.1971 deri me datë 01.05.1997 si dhe periudhën e trajtimit me asistencë sociale nga dt.01.05.1997 deri me dt.01.05.1998.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor është ankuar në shkallë të dytë, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, pala e paditur DRSSH Tiranë duke kërkuar prishjen e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

Shtetasi Sh. P. nga ana e tij na shkruan se i ka drejtuar Kryetarit Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Z.Kastriot SELITA një kërkesë me shkrim me anën e së cilës i ka kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje për shpejtim gjykimi, këtë gjë ai ja ka kërkuar edhe Avokatit të Popullit, Z.Igli TOTOZANI duke pretenduar se jo vetëm është në gjendje jo të mirë shëndetësore si invalidë, por duke patur shumë fëmijë në ngarkim me pak të ardhura ai është edhe në vështirësi të rëndë ekonomike e familjare dhe për rrjedhojë kërkon ndërhyrjen tonë ligjore me anë rekomandimi me objekt shpejtim gjykimi.

Duke analizuar të gjitha faktet, provat dhe rrethanat konkrete të kësaj ankese, arrihet në përfundimin se ankuesit Sh. P. po i shkeljen të drejtat dhe

liritë themelore të Njeriut, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në lidhje me të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj të parashikuar nga kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH dhe nga kërkesat e nenit 6 të KEDNJ.

Kështu, në nenin 3 të Ligjit nr.49/2012 “Për Organizmjin dhe Funksionimin e Gjykatës Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndër parimet e gjyimit administrative ka përcaktuar qartë sigurimin e një procesi të rregullt ligjor brenda afateve sa më të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qënë edhe misioni dhe qëllimi i ligjvënësit shqiptar për krijimin e këtyre gjykatave.

Ligji nga ana e tij synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe qëllimi i krijimit të Gjykatave Administrative ka qënë dhe është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të personave, nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Në nenin 48 të Ligjit nr.49/2012 parashikohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur. Ky qëndrim është përcaktuar qartë edhe nga Jurisprodenca e Gjykatës Kushtetuese në disa vendime të saj siç janë vendimi me Nr.69/2015, vendimi me Nr.85/2015 dhe vendimi tjetër me Nr.14/2016.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: **“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të Njeriut, nga administrata publike”**, dhe kërkesat e nenit 21/c të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se **“ Pas përfundimit të hetimit të një ankese, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”**.

Për sa sipër, Ju

#### **R E K O M A N D O J M Ë :**

1.Të merren masat organizative dhe ligjore për shpejtimin e gjyimit të dosjes administrative të shtetasit Sh. P. dt.17.04.2015, kundra D.R.S.SH. Tiranë, sa më shpejtë në të ardhmen.

2.Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi, dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi të na njoftoni me shkrim brenda afatit ligjor 30 ditor.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**